



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.288/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përberë nga Kryetari i kolegjitet gjyqtari **Faton Ademi** dhe antaret porot Adnan Koroglu dhe Nexhmije Metaj, me procesmbajtse Elheme Peci, ne çështjen juridike të paditëses , nga , të cilën e përfaqëson Av. , nga , kundër te padituri , nga fsh. , baza e kontesit, Besimi i fëmijës, gjykata me dt.21.07.2015, bjen ketë:

A K T G J Y K I M

- I. **APOROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditëses nga , Komuna e ,
- II. Fëmija i mitur , i lindur me dt.01.10.2014 ne i besohen ne ruajtje, ushqim, kujdes dhe edukim, paditëses si nene.
- III. **KONTAKTET** e prindit tjetër-të paditurit me femiun e tij mbisin të lira.
- IV. **OBLIGOHET** i padituri qe ne emër te alimentacionit për fëmijë t'ia paguaj paditëses shumen prej **80 euro**, në muaj nga data 01-10 të çdo muaji.
- V. **OBLIGOHET** Qendra për Punë Sociale ne qe ne baza të rregullta te inspekton trajtimin (kujdesin) e fëmijës nga ana e nenës ne te gjitha aspektet, kontaktin e fëmijës me prindin tjetër si dhe t'i raportoj gjykates ne baza mujore ne lidhje me ketë çështje.
- VI. Secila pale i barте shpenzimet e veta te procedurës

A r s y e t i m

Paditësja me dt.14.05.2015, ka parashtruar padi kundër te paditurit , për shkak te besmit, ruajtjes dhe edukimin e fëmijës se mitur.

Ne seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditses deklaroi: mbeten ne tërësi pran padis dhe kërkespadis, ku pas administrimit të provave nga ana e kësaj gjykate dhe dëgjimintë paditëses nga ana e kësaj gjykate në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se paditësja është në gjendje të kujdeset për fëmiun dhe se interes i fëmiut është të jet bashkë me nënën e tij.

Sa i përket kontakteve edhe ma tutje mbes pranë asaj që ato të jenë të lira për prindërit të cilët do t'i besohen në ruajtje fëmija i mitur. Sa i përket alimentacionit mbeti pranë propozimit si në padi dhe kërkoi nga ana e gjykatës që ta miratoj.

I padituri që nga fillimi e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë dhe mbeti në tërësi pranë deklarimeve të mëhershme, kurse kishte pás qef që fëmija me iu besu atij për shkak të kushteve ma të mira, ajti ma i mirë në katun fëmija u mësu me nënën e të paditurit dhe motrën.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata në seancë kryesore administroi këto prova: raporti i gjendjes për punë sociale nr. ekstrakti i lindjes së fëmiut.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi sipas nenit 7 dhe 8 të LPK-së dhe nga këto prova vërtetoi këtë gjendje:

Është jo kontestuese se fëmija i mitur lindur me datë: 01.10.2014, është fëmi jashtëmartesor pasi prindërit e tij nuk kanë lidhur martesë, ndërsa është jo kontestuese se palët ndërgjyqëse janë prindërit e fëmiut. Këtë fakt nuk e kontestojnë palët ndërgjyqëse.

Në bazë të rapportit të Qendrës për Punë Sociale rekomandimi i Qendrës është që fëmija t'i besohet nënës për shkak të moshës së tij.

Gjykata me kujdes analizoi deklaratat e palëve ndërgjyqëse dhënë në cilësi të palëve: ku pala paditëse deklaroi: se është martuar rrëth 2 vite e gjysëm , raportet në fillim kanë qenë të mira deri kur ka ardh te ndarja. Martesa ka qenë e lidhur përmes msitëve, ku nga kjo martesë ka lindur djali që tanë i ka 9 muaj. Që nga ndarja djali është te babai i tij, ndërsa djalin nuk e ka parë asnjëher prej ndarjes. Në lidhje me kushtet financiare paditësja deklaroi se i ka kushtet e mira; të hyrat e familjes janë rrëth 600 euro në muaj. Sipas

paditëses arsyje e ndarjes ka qenë pasi vjehrrija i kanë bërë zullum ndërsa nga nuk ka pas problem. Një natë para ndarjes i ka thirrë vëllezërit dhe motrën e paditëses për tu marrurvesh, ku gjatë bisedës motra e të paditurit e ka gjuajtur me pirun, në atë moment vëllau ka dashtë me reagu, mirëpo unë ia kam bërë me shenjë që mos të regaon se djalin e kam pas në gji. Atë natë unë kam flejt vëtmë në dhomë ndërsa ka flejtur me prindër. Gjatë natës kam dëgjuar djalin duke qajtur kam shkruar te vjehrrija për të shikuar si ëshhtë djali, ndërsa vjehrri i ka thanë dil prej dhomës, kurse i ka thënë rri këtu, kurse të nesërmendashkë më baban e tij e kanë qit në kerr dhe e kanë dërguar te banesa në , ku aty te dera ka dal vëllau i vogël, i ka thirrë me hi brenda mu marrëvesh, por ata kanë ikur. Paditësja ndër të tjera tha se dy ditë më herët para ndarjes i padituri ia ka vendosur rrypin në fyt, ka dashur që ta fur kurse një natë të tërë e ka ruajtur tërë natën dhe i ka thënë nëse flen "ko me të fur".

I padituri në deklaratën e dhënë para gjykatës ndër të tjera theksoi: se në fillim raportet në mes të tij dhe palës paditëse kane qenë të mira, mirëpo pas lindjes së djalit, kjo duke iu referuar palës paditëse se nuk e ka kqyr djalin, p.sh "në një rast ka qenë tu i dhanë gji, kur e ka thirrë dikush në telefon, e ka lënë djalin tu kajt, ka dal ka fol në telefon, pastaj e ka marrë ky pala e paditur djalin e ka dal. Pala e paditur ka dyshuar në telefonatat që i kanë ardh, edhe pse paditësja i ka thënë se po e thirrë motra, ndërsa sa herë ka pranuar telefonatat ka dal jasht për të folur.

I padituri gjithashtu deklaroi se në telefonin e paditëse kanë ardh sms nga një mashkull, me këtë përbajtje: "A je mirë shpirt".

I padituri nuk e mohoi faktin se në fillim nuk ka pranuar që t'ia lejojë paditëses kontaktin me fëmijë, mirëpo më vonë me ndërmjetësim jo familja, jo rrathi ia ka qitë me pa. Një ditë në mëngjes gjithnjë sipas palës së paditur, pala paditëse i ka thënë babës së të paditurit: "keni me u faru deri në pulë".

Në pyetjen e të autorizuarit të paditëse se cili ka qenë shkaku i ndarjes dhe se a ka pasur vërejtje rreth punëve të shtëpisë, i padituri ka deklaruar se krejt problemi ka qenë rreth djalit.

Duke u bazuar sidomos në faktin se pala e paditur ia ka pamundësuar paditëses kontaktin me fëmiun pas ndarjes, kjo është një ndër shkaqet që Gjykata vendosi që fëmija t'i besohet paditëses si nënë, e po ashtu duke marrë parasysh moshën e fëmijës, nevojat emocionale të të njëjtit, e në rapport me reportin e QPS-së.

Sa i përket kontaktit me fëmijë, meqenëse në mes të palëve nuk kishte kundërshtime që ky kontakt të mbetet i lirë,, gjykata vendosi që kontakti me fëmijë të mbetet i lirë.

Duke marrë për bazë deklaratat e palës së paditur dhe dyshimin e gjykatës rrëth lënies pas dore te kujdesit të paditëses në raport me fëmijë, gjykata vendosi që Qendra për Punë Sociale të ketë rol aktiv duke inspektuar në baza të rregullta mujore gjendjen e fëmijës, kujdesin e të njëjtit nga ana e paditëses.

Në lidhje me alimentacionin gjykata vendosi se shuma e caktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është proporcionale në raport me nevojat e fëmiut, si dhe në rapot me mundësitë e të paditurit.

Gjykata konform nenit 142, 144, 145 dhe nenit 290 të ligjit për Familjen i Kosovës. Aktgjykimi u mor në pajtim me nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.288/2015, Datë: 21.07.2015



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ankesa dorëzohet nëpërmjet kësaj Gjykate

Exp: Blloce

11.7.2015

Blloci